

**Zyrës së doktoratave të Universitetit të Tetovës**  
**Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit filozofik të Universitetit të Tetovës**

Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit filozofik i Universitetit të Tetovës, në mbledhjen e mbajtur më 30.08.2023, solli Vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin shkencor dhe profesional të dorëshkrimit të temës së doktoratës, me titull **“Aspektet socio-kulturore dhe rëndësia e edukimit ekologjik për mbrojtjen e ambientit jetësor në Kosovë”**, të kandidatës Mr.Sc. Ganimete Zogaj.

Në bazë të vendimit nr. 16-402/2, të datës 30.08.2023, Komisioni në përbërje: 1. Prof. Dr. Ibish Kadriu, mentor, 2. Prof. Dr. Abdylnaser Sinani, anëtar, 3. Prof. Dr. Qani Nesimi, anëtar, 4. Prof. Dr. Kushtrim Ahmeti, anëtar, 5. Prof. Dr. Metush Sulejmani, anëtar, pasi lexoi materialin në dorëshkrim, Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit filozofik i paraqet këtë:

**R A P O R T**  
**për vlerësimin e disertacionit të doktoratës**

**Të dhënat biografike të kandidatit:**

Ganimete Smaj Zogaj është lindur më 24 janar të vitit 1981 në Bellanicë-Malishevë, Republika e Kosovës, ku ka kryer edhe shkollimin fillorë dhe të mesëm.

Studimet themelore i ka regjistruar në vitin 2001 në Fakultetin Filozofik, drejtimi Etnologji, në Departamentin e Etnologjisë studime që i ka mbaruar në Shkurt të vitit 2005, duke fituar titullin akademik: “Bachelor i Etnologjisë”.

Pas përfundimit të studimeve “bachelor” në vitin 2005, ka regjistruar studimet e nivelit të dytë - master në Etnologji, si gjeneratë e parë e këtyre studimeve në nivelin master. Gjatë kësaj periudhe kandidatja, ka fituar bursë studimi (“scholarship”) për ndjekjen e një semestri në lëndën përkatëse të Etnologjisë bashkëkohore në “Department of European Ethnology at the University of Vienna”, ku ka fituar njohuri të reja rreth problemeve të shoqërisë kosovare në diasporë.

Studimet e doktoratës në fushën sociologjisë, në modul socio-kulturor i ka regjistruar në vitin akademik 2018/19 në Universitetin e Tetovës nën udhëheqjen e Prof. Dr. Ibish Kadriu, me temë: **“Aspektet socio-kulturore dhe rëndësia e edukimit ekologjik për mbrojtjen e ambientit jetësor në Kosovë”** të miratua nga Këshilli Mësimor Shkencor i Fakultetit Filozofik - Universiteti i Tetovës.

Gjatë kësaj periudhe të studimeve të doktoratës kandidatja Mr. Sc. Ganimete Zogaj i ka kryer me sukses provimet përkatëse, konferencat doktorale, dhe obligimet tjera të parapara me Rregulloren për studimet e doktoratës të Universitetit të Tetovës.

Në vitin 2019 pranohet si asistente e angazhuar për një semestër në lëndën e Sociologjisë, në Fakultetin Ekonomik, drejtimi Administrim Biznesi, në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren.

### **Publikimet shkencore:**

- |   |
|---|
| 1. "Të rënët dhe dëshmorët e UÇK-së nga Shqipëria", Libër, bashkë-autore, Prishtinë, 2013, ISBN: 978-9951-528-52-8.   |
| 2. "Qëndistare në Komunën e Malishevës me Rrethinë" – Libër ISBN 978-9951-528-73-3, 2013.   |
| 3. " <i>NATIONAL COSTUMES IN TODAY'S MODERN TIME</i> ", "Philosophica", Vol.7, No. 13-14, Year 2020. ISSN (print) 1857-9271 d ISSN (online) 2671-3020.  |
| 4. " <i>ENVIRONMENT PROTECTION IN KOSOVO</i> ", <i>International Scientific Journal Monte</i> (ISJM), Vol. 4, No.2 (2021): April (Social Sciences Session), ISSN: 2661-2666 (Online) ISSN: 2661-264X (Print). |

### **Pjesëmarrje në Konferenca Shkencore:**

- |   |
|---|
| 1. <i>Seminari i 36 Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare</i> me temën: Zakonet në dasmat e Regjionit të Llapushës, 24 Gusht 2017.  |
| 2. <b>International Confernce "Migration, reasons, motives and consequences in the society"</b> , Universiteti i Tetovës me temën: "Social media and its impact on children in Kosovo".   |
| 3. <b>The XIII-th international scientific conference</b> ( <i>Konferenca e XIII-të shkencore</i> ndërkombëtare) "Green economic development potentials and implementation opportunities in the countries of the region ("Potencialet e zhvillimit të ekonomisë së gjelbërt dhe mundësitë e implementimit në vendet e rajonit") Prill 2021 Ulqin. |



### **Pasqyrë e aktiviteteve të realizuara nga kandidatja gjatë studimeve të doktoratës:**

Kandidatj Mr. Sc. Ganimete Zogaj që nga fillimi i studimeve në ciklin e tretë të doktoratës e këndeje, ka dëshmuar interes dhe progres të kënaqshëm në fushën e hulumtimit dhe të punimit të disertacionit të doktoratës. Ajo me sukses ka realizuar tre konferencat doktorale, gjatë të cilave ka prezantuar rezultatet e hulumtimit. Gjatë kësaj periudhe ka botuar disa punime, artikuj shkencorë në revista ndërkombëtare të fushës dhe ka marrë pjesë në disa konferenca shkencore vendore dhe ndërkombëtare.

### **Analizë e punimit të doktoratës me titull "Aspektet socio-kulturore dhe rëndësia e edukimit ekologjik për mbrojtjen e ambientit jetësor në Kosovë"**

Ky disertacion i doktoratës ka një ndarje të përgjithshme prej dy pjesësh, pjesa e parë-pjesa teorike dhe pjesa e dytë empirike, ku janë shfrytëzuara metoda të hulumtimit, varësisht nga rezultatet e pritura. Disertacioni i doktoratës është i strukturuar në pesë kapituj, sipas çështjeve që trajtohen dhe metodologjisë së shfrytëzuar.

Pjesa e parë e disertacionit të doktoratës me titull "Aspektet socio-kulturore dhe rëndësia e edukimit ekologjik për mbrojtjen e ambientit jetësor në Kosovë" të kandidatës Mr.Sc. Ganimete Zogaj, është pjesa teorike e cila përbëhet nga katër (4) kapituj.

Ndërkaq, pjesa e dytë është pjesa empirike përfshihet në kreun e pestë të këtij disertacioni.

**Kreu i parë:** Kapitulli i parë merret me vështrimin e gjendjes së përgjithshme të mjedisit jetësorë global, vetëdija dhe edukimi ekologjik, etikën ekologjike, teoritë antropocentike, ekocentrike, dhe biocentrike, disa nga instrumentet juridike dhe politike në mbrojtje të ambientit, politika ekologjike në kuadër të burimeve primare të së drejtës Evropiane.

Kapitulli është një përshkrim të përgjithshëm për atë që qenë e mundur brenda kësaj hapësire të gjendjes mjedisore në përmasa globale. Kjo paraqitje edhe pse pa pretendime për ta shterur në detaje, është barë e nxitur nga disa shtysa kryesore, për të treguar për ndërlidhjen që ekziston sot ndërmjet shqetësimeve ekologjike në Kosovë si dhe në vendet tjera, pra për të dëshmuar që tashmë kjo temë nuk është preokupim i asnjë shteti dhe shoqërie të izoluar, sepse bota edhe në këtë sferë është shndërruar në një "fshat global" dhe po ashtu duke e pasur në konsideratë postulatën e njohur ekologjik, mendo në mënyrë globale dhe vepra në mënyrë lokale.

**Kreu i dytë** përbëhet nga gjashtë nënkapituj dhe titullohet "Fakte themelore mbi Republikën e Kosovës", e ku tentohet të hidhet vështrim mbi gjendjen e përgjithshme të ambientit jetësor në Kosovë, ndotjen e ajrit, ndotja e ujit, menaxhimi i mbeturinave, gjendja e tokës në Kosovë dhe biodiversitetin dhe sfidat për ruajtjen e tij. Në këtë kapitull, flitet për sfidat e mbrojtjes së ambientit dhe disa faktorë që mund të ndikojnë në përmirësimin, rigjenerimin e mjedisit apo edhe vetë ruajtjen origjinale të mjedisit. Megjithatë, përtej këtyre karakteristikave të përgjithshme, edhe në Republikën e Kosovës problemet e mjedisit me kalimin e kohës janë bërë një çështje urgjente. Gjashtë nënkapituj janë:



**Kreu i tretë:** Ky kapitull ka për bosht tematik kryesisht disa nga masat kushtetuese, ligjore, administrative dhe institucionale dhe strategjive shtetërore në adresimin e mbrojtjes së ambientit në Republikën e Kosovës. Duke mos lënë anash as obligimet formale dhe kontraktuale që Kosova ka marr si rezultat i përafrimit me BE-në dëshmon për një çarje që e karakterizon prej kohësh Republikën e Kosovës, ku edhe pse në shumë drejtime ky shtet ia ka dalë të hartojë një legjislacion adekuat në sferën e ambientit jetësor, që në shumëçka është konform normave rregullativave të BE-së, sidomos krye parimit të saj “ndotësi paguan” megjithatë zbatimi praktik i tyre ka qenë sfidë në vetvete.

Duke krijuar në këtë mënyrë një paradoks të çuditshëm, që degradimi i ambientit jetësor në Kosovë të ndodh në një kohë kur në fuqi janë disa nga ligjet më të avancuara që e mëtojnë ta mbrojnë atë. Dihet kjo, që ka nevojë urgjente të tejkalohet, nëse mirëfilli dëshirojmë të kemi një ambient më të pastër. Ky kapitull shqyrton etikën dhe ligjëshmërinë ndaj ambientit jetësor në Kosovë duke vënë theksin tek diversiteti kulturor, etnik dhe religjioz të shoqërisë kosovare, do duhet të ndërtojmë politika gjithëpërfshirëse për të promovuar vlerat e përbashkëta etike në aspektin e edukimit ligjor dhe sundimit të ligjit. Në këtë mënyrë shteti sot ka për obligim që të garantojë edhe mbrojtjen e mjedisit.

**Kreu i katërt** është i ndarë në katër nënkapituj dhe shtjellon rëndësinë e edukimit ekologjik dhe vetëdijes ekologjike, ku vetëdija dhe angazhimi i forcave njerëzore për përmirësimin e gjendjes së mjedisit jetësor është ndër çështjet më të rëndësishme të jetës sonë në planetin tonë. Mbrojtja e mjedisit duhet të praktikohet, në nivel individual, të organizatave dhe të qeverisë, në dobi të mjedisit natyror dhe të qenieve njerëzore në shoqëri. Kapitulli i katër merret me aspektet socio – kulturorë në ruajtjen e ambientit jetësor. Edhe në Kosovë, ruajtja e mjedisit paraqet një nga sfidat kryesore në aspektet socio – kulturorë.

Pas analizimit të “infrastrukturës ligjore” dhe politike në Kosovë është me rëndësi që të shtjellohet edhe dimensionin kulturorë i vetëdijes ekologjike në shoqërinë kosovare. Ngase është ky segment, ku formohen bindjet, qëndrimet dhe prirjet kolektive të një shoqërie si dhe bëhet promovimi i qytetarisë ekologjike. Me këtë rast, në këtë kapitull analizohet kultura e vetëdijes ekologjike në Kosovë.

**Kreu i pestë:** prezanton rezultatet e hulumtimit i cili ka për qëllim të zbulojë ndikimin e kulturës dhe edukatës ekologjike në qëndrimet dhe veprimet e individëve ndaj mjedisit në Kosovë dhe të nxjerrë në pah rëndësinë e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e mjedisit. Për këtë hulumtim janë marrë të dhëna parësore nga një mostër prej 302 respondentëve. Kjo mostër është përdorur për të përfaqësuar një spektër të gjerë të shoqërisë kosovare dhe për të siguruar një pasqyrë sa më të qartë të mendimeve dhe qëndrimeve të saj ndaj çështjeve mjedisore. Në vijim të këtij kapitulli, janë analizuar dhe interpretuar të dhënat e mbledhura, duke përdorur programin statistikor SPSS. Ky program është një ndër mjetet më të avancuara për analizën e të dhënave në hulumtimin shkencor dhe ka ndihmuar në ekstraktimin e informacioneve kyçe nga të dhënat e grumbulluara dhe në daljen me përfundime të sakta për këtë studim. Rezultatet mendojmë se sjellin një ndihmesë të çmuar në kuptimin e aspekteve socio-kulturore në Kosovë dhe ndikimin e tyre në edukimin ekologjik dhe mbrojtjen e ambientit jetësor. Ky kapitull përbëhet prej dymbëdhjetë nënkapituj.



### **Përshkrim i shkurtër i metodave të përdorura:**

Në disertacionin e doktoratës me titull "Aspektet socio-kulturore dhe rëndësia e edukimit ekologjik për mbrojtjen e ambientit jetësor në Kosovë", të kandidatës Mr. Sc. Ganimete Zogaj, është ndjekur logjikën metodologjike se si veprimet njerëzore kanë ndikuar në natyrë dhe anasjelltas. Ky relacion reciprok dallohet më shumë se askund tjetër në marrëdhëniet që shtresëzohen ndër vite, dekada dhe shekuj në mes të kulturës dhe ambientit jetësor. Nëse filozofi i njohur G.W.Hegeli, dikur pohonte se "historia dhe njohja njerëzore janë identike me kohën" në këtë linjë të mendimit të tij, mund të konstatojmë po ashtu se edhe kultura ndryshon me kohën. Mirëpo, ky ndryshim reflektohet edhe në ambientin fizik dhe njerëzor, pra në një mënyrë, kultura, shoqëria dhe ambienti e formojnë një trekëndor që nuk mund të shpëputen nga njëra tjetra. Kjo ka ndikuar që edhe kultura të ndryshme të kenë qasje të ndryshme ndaj ambientit jetësorë. Madje, brenda së njëjtës kulture me kalimin e kohës të ketë ndryshuar qëndrimi dhe vetëdija e individëve të një shoqërie në raport me natyrën. Çdo hulumtim shkencor me qëllim që të jetë sa më kredibil bazohet mbi disa parime metodologjike.

Procedura ose strategjia e hulumtimit lidhet me mënyrën e planifikimit dhe kryerjes së saj. Pra, pikërisht kjo nënkupton zgjedhjen e metodës së duhur të studimit dhe përcaktimin e mënyrës së zbatimit të tij në fushën e studimit. Në këtë kontekst, të gjitha hulumtimet dhe kërkimet fillojnë me një problem studimi (hulumtimi). Bie fjala, sikurse në rastin e këtij studimi, çfarë po ndodhë me ambientin jetësor në Kosovë? Dhe, nivelin e vetëdijes ekologjike, por duke mos lënë anash as krahasimin me vendet tjera, në drejtim të mbrojtjes së ambientit jetësorë. Cilët janë faktorët që kanë ndikuar në përkeqësimin ekologjik të ambientit jetësor? Pra, studimi për zgjidhjen e së panjohurës përpiqet më tepër të na ndihmojë të kuptojmë përse ngjarjet ndodhin ashtu si ndodhin, në vend se t'i pranojmë thjesht si fakte. Por, një nga detyrat e këtij disertacioni është të na bëjë të kuptojmë lidhjet kauzale ndërmjet fenomeneve sociale.

Shpeshherë ndodh që edhe pasi t'i kuptojmë këto shkaqe, veprimi konkret në ndryshimin e tyre mbetet problem. Në kohën e sotme bashkëkohore mbase nuk është sfidë shumë e madhe identifikimi i problemeve mjedisore, por zgjidha e tyre shoqërore, ekonomike dhe politike mbetet shumë komplekse. Prandaj, kombinimi i disa instrumenteve metodologjike konsiderohet vendimtar në analizimin këtyre fenomeneve.

Kjo rrugë hulumtimi është ndjekur edhe në këtë disertacion doktorate. Metodologjia e këtij hulumtimi mëton të jetë sa më e pasur në mënyrë që të mund t'i arrijmë objektivat e parashtruara. Janë përdorur një sërë metodash, që aktualisht përdoren në shkencat shoqërore në përgjithësi si metoda kualitative (cilësore), metoda kuantitative (sasiore), metoda e analizës, sintezës, induksionit, deduksionit, krahasues dhe historike.

Metodat, dhe rezultatet nga to janë të paraqitura dhe diskutuara gjatë tërë hulumtimit, në varësi nga çështjet teorike që trajtohen. Por, mbështetja metodologjike dhe sqarimi i gjetjeve nga metodat është paraqitur në pjesën e dytë të këtij disertacioni të doktoratës – pjesën empirike. Kjo pjesë zhvillohet nga Kreu i pestë i këtij hulumtimi.



### **Përshkrim i shkurtër i rezultateve të hulumtimit:**

Në mënyrë që rezultatet e këtij hulumtimi të jenë relevante, dhe të lidhura ngushtësisht me temën e disertacionit "Aspektet socio-kulturore dhe rëndësia e edukimit ekologjik për mbrojtjen e ambientit jetësor në Kosovë" ndërtohet mbi një hipotezë kryesore dhe mbi katër hipoteza ndihmëse dhe tri pyetje kërkimore-shkencore.

**H1:** Mbrojtja e ambientit jetësor në Kosovë synon t'u përgjigjet sfidave dhe problemeve ekologjike, ambientale dhe mjedisore, si dhe duke potencuar rëndësinë që e ka edukimi ekologjik si dhe aspektet socio-kulturore në vetëdijësimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve në mbrojtje të ambientit.

**H2:** Mbrojtja e ambientit dhe identifikimi i problemeve mjedisore

**H3:** Roli i faktorit njeri në bashkëpunimin në mes institucioneve përkatëse si dhe vetëdijësimin e shoqërisë për rëndësinë e ambientit të pastër.

**H4:** Etika dhe kultura ambientaliste e shoqërisë kosovare dhe krahasimi i saj me trendet globale.

Në funksion të elaborimit sa më të detajuar dhe verifikimit të këtyre hipotezave, po ashtu në këtë punim pretendohet që t'u jepet përgjigje këtyre pyetjeve kërkimore-shkencore:

**P1:** Cili është roli dhe ndikimi i faktorit njeri në mbrojtjen e ambientit jetësor në Kosovë gjatë kohës sa bën fjalë ky studim?

**P2:** A kanë ndikuar mënyrat e reja të edukimit dhe mediave në një koncept dhe model të ri të informimit dhe sensibilizimit të qytetarëve për edukimin ekologjik dhe si ka ndikuar kjo në jetën e tyre?

**P3:** Cilat janë përgjegjësitë e akterëve politikë, publikë dhe institucioneve, sikurse se; MMPH, Kuvendi, Agjencitë qeveritare dhe publike, si dhe organet tjera shtetërore të qeverisjes në nivel lokal në mbrojtje të ambientit, si dhe sa kanë qenë efektive për sanksionimin e detyrueshëm për moszbatim të masave adekuate në mbrojtje të ambientit jetësor?

Përgjithësisht me anë të këtij studimi pritet që të kemi mundësi ta njohim më mirë lindjen, ndryshimin dhe zhvillimin e problemeve mjedisore.

Kështu, me anë të analizës së rezultateve të fituara dhe të mbledhura nga përdorimi i metodave të lartëshënuara, do të analizohen si për nga cilësia ashtu edhe nga sasia, për të cilat është ndërtuar edhe një mendim kritik. Po ashtu, nga kjo procedurë hulumtuese do të kemi mundësi të shohim më nga afër se si bëhet zbatimi i ligjeve dhe strategjive që kanë për fokus mbrojtjen e mjedisit jetësorë në Republikën e Kosovës. Të gjitha këto me qëllim të avancimit dhe ngritjes së njohurive si dhe kompetencës profesionale, shkencore dhe morale në mbrojtjen e ambientit jetësor.

### **Kontributet kryesore shkencore të kandidatit:**

Tema që trajton kandidatja Mr. Sc. Ganimete Zogaj në këtë disertacion doktorate, është mjaft e rëndësishme, dhe si e tillë ka pak hulumtime të kësaj sferë e sidomos në Republikës e Kosovës. Në këtë kërkim shkencor, ka hulumtuar aspektet socio – kulturore, marrëdhënien midis njeriut dhe natyrës, organizimeve të ndryshme njerëzore për edukim ekologjik dhe performancës të akterëve tjerë që veprojnë për një ambient të pastër në Kosovë. Gjithashtu, pjesën më të madhe të këtij disertacioni të doktoratës e përshkon mbrojtja e ambientit jetësor në ditët e sotme, ndryshimet që po pëson natyra dhe biodiversiteti si dhe sfidën e madhe për mbrojtjen e ambientit nga vetë njeriu. Ky disertacion doktorate ka hedhur një analizë për rëndësinë e edukimit ekologjik, kujdesin ndaj natyrës dhe mbrojtjen e saj, respektimin dhe zbatueshmërinë e ligjeve për mbrojtjen



e ambientit, mediat sociale dhe të gjithë aketerët tjerë me të gjitha resurset njerëzore që informojnë e sensibilizojnë njerëzit për mbrojtjen e ambientit jetësor.

Në këtë disertacion të doktoratës me titull "Aspektet socio-kulturore dhe rëndësia e edukimit ekologjik për mbrojtjen e ambientit jetësor në Kosovë", kandidatja Mr. Sc. Ganimete Zogaj, ka shfrytëzuar burime teorike dhe pikëpamje socio-kulturore dhe politike mbi problemin e hulumtimit, për të gjetur njohuritë, vetëdijen ekologjike, zbatimin e ligjeve, sensibilizimin mediatik si dhe rolin e faktorit njeri ndaj ambientit jetësor në Republikën e Kosovës, për të kontribuar në zhvillimin e jetës sociale e kulturore dhe për të nxitur një zhvillim të ri në mbrojtje te ambientit dhe edukim ekologjik të gjithanshëm.

### **Hulumtime të mundshme në të ardhmen:**


Disertacioni i doktoratës me temë "Aspektet socio- kulturore dhe rëndësia e edukimit ekologjik për mbrojtjen e ambientit jetësor në Kosovë", përfshin një studim shumë të gjerë, por në të njëjtën kohë arrin specifikat e shumta të aplikuara por pak të njohura shkencërisht në Republikën e Kosovës për rolin i faktorit njeri në ngritjen e vetëdijes në kontekst të mbrojtjes së ambientit jetësorë në Kosovë. Prandaj, kandidatja ose edhe studiues të tjerë mund të trajtojnë shumë çështje të veçanta që prek ky disertacion. Kandidatja Mr. Sc. Ganimete Zogaj ka bërë përpjekje të pasqyrojë rëndësinë që ka edukimi ekologjik dhe mbrojtja e ambientit jetësor në Republikën e Kosovës, që implikon edhe zhvillimin e përgjithshëm social e kulturor. Prandaj, çështjet e ngritura në këtë disertacion janë një kontribut jo vetëm për sferën e sociologjisë apo të kulturës, por në të njëjtën kohë ndërldihen edhe me krijimin e problemeve të shumta sociale si pasojë e cenimit të ambientit jetësorë por edhe të ndryshimit të mënyrës së jetesës ndaj natyrës si dhe mendimit të gjerë social për çështje të caktuara mjedisore. Ky disertacion i doktoratës mund të shërbejë për hulumtime shkencore në sferën e rëndësisë së edukimit ekologjik, kujdesin ndaj natyrës dhe mbrojtjen e saj, respektimin dhe zbatueshmërinë e ligjeve për mbrojtjen e ambientit, mediat sociale dhe të gjithë aketerët tjerë me të gjitha resurset njerëzore që informojnë e sensibilizojnë njerëzit për mbrojtjen e ambientit jetësor në Republikën e Kosovës, por edhe më gjerë.


**Vlerësim dhe rekomandim:**

Nisur nga vlerësimet e mësipërme, Komisioni shkencor për vlerësimin e dorëshkrimit të temës së doktoratës “Aspektet socio- kulturore dhe rëndësia e edukimit ekologjik për mbrojtjen e ambientit jetësor në Kosovë”, të kandidatës Mr. Sc. Ganimete Zogaj, ka nderin që t’i propozojë Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Filozofik miratimin e këtij raporti dhe krijimin e kushteve për mbrojtjen publike të kësaj teme të doktoratës.


**Komisioni:**

1. Prof. Dr. Ibish Kadriu, mentor  ;

2. Prof. Dr. Abdylnaser Sinani, anëtar  ;

3. Prof. Dr. Qani Nesimi, anëtar  ;

4. Prof. Dr. Kushtrim Ahmeti, anëtar  ;

5. Prof. Dr. Metush Sulejmani, anëtar  ;